

## STATUT - "MINA NExT Level Center" shpk.

### STATUT "MINA NExT Level Center" shpk.

Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Sot, me 08/08/2023, unë:

**Andi Hoxha** shtetas shqiptar, i biri i Besnik dhe Burbuje, datëlindja 10/05/1977, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga Urani Pano, Godina 1, Hyrja 1, Ap 17 madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 036834281 dhe nr. personal H70512059M ne përputhje me Ligin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" dhe me legjislacionin e zbatueshëm ne Republikën e Shqipërisë, vendosa të miratoj këtë Statut si vijon:

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- "Statuti" është ky Statut i Shoqërisë;

#### **Kreu I** **Themeli, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

#### **Neni 1 - Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, më 08 /08/2023, unë, themeluesi i mësipërm, themeloj shoqerinë me përgjegjësi të kuqizuar me emrin dhe emërtimin tregtar "MINA NExT Level Center" sh.p.k.

#### **Neni 2- Objekti**

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

- Ofrimin e konsulencave në fusha të ndryshme si ajo financiare, fiskale, ligjore etj si dhe ofrimin e shërbimeve të të gjithja llojeve në këto fusha në përgjithsi dhe në veçanti gjatë aplikimeve digitale online në e-albania dhe në çfarëdo platforme tjeter financiare, fiskale, ligjore etj të menaxhuar nga shteti shqiptar për çdo lloj shoqërish - të huaja apo vendase, publike apo private tregtare dhe/ose jo fitimprurëse si dhe për çdo individ shqiptar ose të huaj gjatë detyrimit për përdorim të platformave të ndryshme digitale online.
- Shërbime konsulencë financiare përfshirë asistencë në lidhje me legjislacionin fiskal, mjedisor etj si dhe përshtatje me strukturat e kompanive. Asistencë në kontabilitetin e brendshëm të shoqërive të ndryshme duke përfshirë por pa u kufizuar në ngritjen e sistemeve të brendshme të menaxhimit të informacionit, ndjekjen e mardhënieve me bankat për kreditë, sistemin e pagesave online, ndjekjen e mardhënieve me klientët e tyre dhe/ose furintorët e tyre, menaxhimin e burimeve njerëzore, ndjekjen e praktikave të punësimit apo çfarëdolloj kërkese specifike që ato mund të kenë; ofrimin e ndërmjetësimit në shërbime të specializuara profesionale në fushën e kontabilitetit, auditimit dhe përfaqësimit ligjor.
- Shërbime Konsulencë ligjore përfshirë shërbime në hartimin e kontratave të ndryshme, kërkësave dhe akteve të ndryshme ligjore; përgatitjen e dokumentacionit dhe ndjekjen e procedurave perkatese me institucionë të ndryshme si QKB, Gjykata, Zyra përmbarimore, Bashki etj. Menaxhimin e dokumentacionit ligjor etj.
- Shoqëria ka për objekt kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe /ose pjesmarrien në çdo veprimtar apo aktivitet te ligjshëm që mund të kryeje një shoqëri në baze të legjislacionit shqiptar. Shoqëria kryes çdo aktivitet tjeter që lidhet në mënyrë direkte dhe indirekte dhe që i shërben përmbrushjes së aktiviteteve si më lart.

#### **Neni 3 - Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pacaktuar dhe/ose e pakufizuar.



## STATUT - "MINA NExT Level Center " shpk.

### Neni 4 - Selia

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Rugja Bardhok Biba, Godina 140, Hyrja 4, ap 140 Tirane.** Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

### Kreu II Kapitali

#### Neni 5 - Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është ALL 200.000 (dyqind mijë lekë). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Andi Hoxha** : Zotëruesh i **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme ALL 200.000 që përbën **100% të kapitalit themeltar të shoqërisë**.

Kontributi i ortakëve është në para dhe do të shlyhet prej tyre menjëherë me themelin e shoqërisë. Secili ortak do te kete një numer proporcional votash me vleren nominale te kuotes se tij.

#### Neni 6 - Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### Neni 7 - Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve dhe te shoqëritë kontrolluese dhe/ose te grupit te caktuara me vendimin e Asamblesë. Pjesët e kapitalit mund te kalohen te te tretet vetëm me miratimin e Asamblesë se Përgjithshme, që jepet nëpërmjet një vendimi të mare me unanimitet. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 8 - Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;



## STATUT - "MINA NExT Level Center " shpk.

- 
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) shperndarjen e fitimeve vjetore;
  - j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

### **Neni 9 - Mënyra e Thirrjes se Mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme**

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve mblidhet ne rastet e përcaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here qe është e nevojshme për te mbrojtur interesat e Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mblidhet te paktën një here ne vit.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve do te thirret nga Administratoret dhe, kur është e zbatueshme, nga Ortaket. Njoftimi për thirrjen e Asamblesë se Përgjithshme mund te dërgohet me shkrim apo e-mail ne adresat qe secili Ortak do t'i njoftoje me shkrim Shoqërisë me poste te regjistruar. Njoftimi do te konsiderohet se i është dorëzuar Shoqërisë me kalimin e ditës se 7-te pas dërgimit.

Njoftimi për thirrjen e Asamblesë duhet te percaktoje qarte emrin e Shoqerise, seline, daten, kohen dhe vendin e mbledhjes, një pershkrim te hollesishem te procedures qe duhet te ndiqet nga Ortaket per pjesemarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyren e marries se dokumenteve dhe projekt-vendimeve qe duhet tu vihen ne dispozicion te gjithe Ortakeve, po ashtu edhe rendin e ditës, dhe duhet t'u njoftohet Ortakeve te pakten 7 (shtate) dite para mbledhjes. Rendi i ditës i njoftuar si me sipër duhet te përbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve duhet te vendose për ndryshime te Statutit, teksti përkatës duhet te njoftohet se bashku me rendin e ditës.

Ortaket mund te marrin pjese ne mbledhjet e asamblesë se përgjithshme nëpërmjet mjeteve te ndryshme te komunikimit, perfshire mjetet e komunikimit elektronik, qe garantojnë identifikimin e ortakeve. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to: a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale; b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër; c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë se përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjese në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

Një Ortak mund te përfaqësohet ne Asamblenë e Përgjithshme te Ortakeve nga një ortak tjetër apo nga një person i trete i ndryshëm nga Administratoret, duke paraqitur dokumentin përkatës autorizues. Autorizimi mund te jepet vetëm për një mbledhje te Asamblesë se Përgjithshme te Ortakeve, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me te njëtin rend dite.

Te gjitha vendimet e Asamblesë duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratoret janë përgjegjës për mbajtjen e një kopjeje te tij.

### **Neni 10 - Kuorumi**

Në rastin e marries së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse



## **STATUT - "MINA NExT Level Center " shpk.**

ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 11 - Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zotëruvesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pranë QKB për te pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.

### **Neni 12 - Përjashtimi nga e drejta e votës**

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 13 - Administrimi**

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit eshte 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë të shoqërisë për një mandat 5 (pesë) vjeçar emërimi:

- **Nerisa Kazazi** shtetas shqiptar, e bija e Skenderit dhe Shpresa, datëlindja 14/03/1979, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me **adresë Rruga Urani Pano, Godina 1, Hyrja 1, Ap 17** madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 034239403 dhe nr. personal H95314164B
- **pa kufizime ne kompetencat e administrimit.**

### **Neni 14 - Kompetencat e Administratorëve**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruanë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përrpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;



## STATUT - "MINA NExT Level Center " shpk.

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;  
ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emeron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontrakte me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### Neni 15 - Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim a mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërbleshje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërbleshje shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme: u kthen ortakëve kontributet; u paguan ortakëve interesa apo dividendë; u shpërndan aktivet shoqërisë; lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikojë që shoqëria nuk do të kishte paguese për të shlyer detyrimet; jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.



## STATUT - "MINA NExT Level Center " shpk.

### Kreu IV

#### Viti finanziar-ekspertet

##### Neni 16 - Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

##### Neni 17 - Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithevjetor dhe ate ne lidhje me kontrolllet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perqatit reportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrolllet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejttes vendimore qe ka.

### Kreu V

#### Prishja – Riorganizimi i Shoqërisë

##### Neni 18 - Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne edo kohe: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; me vendim te Asamblese se Ortakeve; me hapjen e procedurave te falimentimit; ne përputhje me pikën 3 te nenit 43 te ligjit 9723/2007; me vendim te gjykatës.

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne edo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftësisë paguese, me përijashtim te rasteve kur eshtënisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

##### Neni 19 - Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund te ndahet, bashkohet sipas Vednitit te Mbledhjes se Përgjithshme te Asamblesë se Ortakëve, ne përputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesën IX te Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

##### Neni 20 - Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

##### Neni 21 - Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua nga ortaku themelues si vijon:

**ORTAKU THEMELUES  
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"MINA NExT Level Center" sh.p.k**

Andi Hoxha

